



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



A.nr.484/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani,-kryetar, Ardita Haxhnikaj – Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtare, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr. 484/2026, të datës 29.04.2026, të parashtruar nga ankuesi N.Sh, kundër organit të punësimit Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, në çështjen juridike “*Pezullim nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr. 484/2026, e datës 29.04.2026, e parashtruar nga ankuesi N.Sh.

II. Mbetet në fuqi, Vendimi me numër protokolli 4164, i datës 11.04.2026, i U.D Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit.

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes vendimit A.nr. 1915/2025, të datës 10.03.2026, ka nxjerr vendimin përmes të cilit vendim ka aprovuar ankesën A.nr. 1915/2025, të datës 19.11.2025, e parashtruar nga ankuesi N.Sh, duke shfuqizuar vendimin me numër protokolli 10594/01, i datës 13.11.2025, të ushtruesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke e kthyer çështjen në rishqyrtimin dhe rivendosje tek organin kompetent për shkak se organi punëdhënës kishte pezulluar ankuesin duke u bazuar në një aktakuzë fiktive.

Me qëllim të zbatimit të vendimit A. Nr. 1915/2025, të datës 10.03.2026, të Këshillit, U.D Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, përmes vendimit me numër protokolli 4164, të datës 10.04.2026, ankuesin e pezullon nga marrëdhënia e punës sipas detyrës zyrtare në pozitën Drejtor i Departamentit të Automjeteve në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit dhe se pezullimin nga

marrëdhënia e punës për ankuesin N.SH, fillon nga data 10.04.2026, me kompensimin e pagës së tij deri në 50% e deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Gjykata Kompetente.

Ankuesi N.SH, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi) me datë 29.04.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 4164, i datës 11.04.2026, i U.D Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, lidhur me pezullimin e marrëdhënies së punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A.Nr.484/2026 të datës 29.04.2026, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopje e letërnjoftimit për ankuesin N.Sh; Vendimi me numër protokolli 4164, i datës 10.04.2026, i nxjerr nga U.D Sekretari i Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit; Kërkesë për çasje në dokumente zyrtare me numër protokolli 4415, i datës 20.04.2026; Emalin e datës 11.02.2026, dërguar nga L.O, tek E.Sh; Emalin e datës 13.01.2026, dërguar nga L.O, tek E.Sh dhe R.K; Emalin e datës 25.09.2025, dërguar nga I.B, tek L.O; Ankesën A.Nr.1915/2025 të datës 18.11.2025, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emalin e datës 30.09.2025, dërguar nga I.B, për N.Sh.B.S; Emalin e datës 30.09.2025, dërguar nga N.Sh, për I.B; Vendimi me numër protokolli 10954, i datës 13.11.2025, i Ushtruesit të Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI; Emalin e datës 13.11.2025, dërguar nga P.S, për I.B,etj; Aktakuzë PPS Nr. 40/2019, e Prokurorisë Speciale; Kopje e letërnjoftimit për ankuesin N.Sh; Vendimi A. Nr. 1915/2025, i datës 10.03.2026, i Këshillit; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 1915/2025, e datës 01.12.2025; Akt Emërimi i datës 03.07.2014, për ankuesin N.Sh; Vendimi me numër protokolli 10520, i datës 12.11.2025, i nxjerr nga i Ushtruesit të Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI; Vendimi me numër protokolli 10594, i datës 13.11.2025, i nxjerr nga i Ushtruesit të Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI; Përshkrimi i detyrave të Punës për pozitën “ Drejtor i Departamentit të Automjeteve”; Emalin e datës 11.11.2025, dërguar nga A.K, për L.O; Emali i datës 30.09.2025, dërguar nga I.B, për L.O; Emali i datës 24.09.2025, dërguar nga H.K, për Sh.G; Emali i datës 24.09.2025, dërguar nga I.B, për L.O; Ankesë e datës 18.11.2025, drejtuar Këshillit; Emali i datës 30.09.2025, dërguar nga I.B, për N.SH B.T; Emali i datës 30.09.2025, dërguar nga I.B, për N.SH B.T;

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit ka gjetur së ankesa është e pabazuar, sepse:

Nga provat e administruara rrjedhë së ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 03.07.2014, është e punësuar në pozitën Drejtor i Departamentit të Automjeteve në MMPHI .

Me qëllim të zbatimit të vendimit A.nr. 1915/2025, të datës 10.03.2026, të Këshillit, U.D Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, përmes vendimit me numër protokolli 4164, të datës 10.04.2026, ankuesin e pezullon nga marrëdhënia e punës sipas detyrës zyrtare në pozitën Drejtor i Departamentit të Automjeteve në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit dhe se pezullimin nga marrëdhënia e punës për ankuesin N.Sh, fillon nga data 10.04.2026, me kompensimin e pagës së tij deri në 50% , deri në marrjen e vendimit tjetër.

Ankuesi N.Sh, i pakënaqur me vendimin me numër 4164, të datës 10.04.2026, të U.D Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, me datë 29.04.2026, parashtrohet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se vendimi është marrë duke shkel të drejtën materiale dhe procedurale.

Kolegji i Këshillit, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit të parashtuara si në ankesë, analizoi legjislacionin e aplikueshëm për nëpunësit civil, në kohen e nxjerrjes së aktit të kontestuar Ligjit nr. 08/l-294, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 08/l-197 për Zyratet Publik, gjegjësisht; *neni 13, paragrafi 1, i këtij ligji ku përcaktohet se: 1. Në nenin 69, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.5. të ligjit bazik ndryshohet si në vijim: 1.5. ndaj nëpunësit civil është ngritur aktakuzë për procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, si dhe nenin, 4, paragrafi 1 neni 5, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5, neni 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5, të Rregullores (QRK) NR. 28/2024 për Pezullimin nga Marrëdhënia e Punës, ku përcaktohet se; 1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies së punës në shërbimin civil që bëhet: 1.1. sipas detyrës zyrtare 1. Nëpunësit civil i pezullohet marrëdhënia e punës sipas detyrës zyrtare në këto raste: 1.5. ndaj nëpunësit civil është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij; 1. Pezullimi sipas detyrës zyrtare për rastet e përcaktuara në nenin 5 të kësaj Rregulloreje, bëhet për këtë kohëzgjatje: 1.5. deri në përfundimin e procedurës penale sipas nën paragrafit 1.5 të paragrafit 1, të nenit 5 të kësaj Rregulloreje, prandaj bazuar në këtë konstatim ligjor Kolegji i Këshillit konstaton se sipas emalit të datës 11.02.2026, të dërguar nga Udhëheqësja e Zyrës për Informim dhe Komunikim me Media e Gjykatës Themelore në Prishtinë, ku në këtë emali theksohet se; se referuar kërkesës tuaj për Informata, ju njoftoj se në Gjykatën Themelore në Prishtinë në Prishtinë -Departamenti Special, është duke u zhvilluar procedurë gjyqësore lidhur me të pandehurin N.Sh, sipas Aktakuzës PPS.Nr. 40/19, të datës 04.02.2022 dhe se nga gjyqtarja e kësaj çështje penale jemi informuar se rasti është në shqyrtim gjyqësor dhe lënda mbanë numrin Ps.nr. 14/2025 dhe me numër unik SMIL 2020;057879 dhe për njoftimin tuaj rasti është në rigjykim, andaj mbi bazën e kësaj Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara.*

Kolegji i Këshillit, bazuar në kuadrin përkatës ligjor, po ashtu ka analizuar aktin e goditur me ankesë, gjegjësisht vendimit me numër protokoli 4164 të datës 10.04.2026 të U.D Sekretarit të Përgjithshme të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, përmes të cilit vendim ankuesin i është pezulluar marrëdhënia e punës, dhe si rrjedhojë ka gjetur se i njëjti është nxjerrë mbi bazën e dispozitave të Ligjit nr. 08/l-294, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 08/l-197, si dhe Rregullores (QRK) NR. 28/2024 për Pezullimin nga Marrëdhënia e Punës, duke vërtetuar drejte gjendjen faktike dhe bazën, juridike lidhur me pezullimin e marrëdhënies së punës për ankuesin.

Andaj, nisur nga konstatimet si me lartë Kolegji i Këshillit konstaton se pezullimi i marrëdhënies së punës së ankuesit është bërë në përputhje me ligjin material, sipas dispozitave të nenit neni 13, paragrafi 1, të Ligjit nr. 08/l-294, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 08/l-197 për Zyratet Publik, dhe se mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se vendimi i kundërshtuar me ankesë është i ligjshëm, në kuptim të nenit 47 dhe nenit 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe për rrjedhojë pretendimet ankimore të ankuesit nuk qëndrojnë dhe si të tilla janë të pa bazuara.

Kolegji i Këshillit, i ka shqyrtuar edhe pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se vendimin për pezullimin nga marrëdhënia e punës duhet të merret me përputhje me nenin 63, paragrafi 3, i Ligjit Nr.03/l-149, për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi që ka analizuar këtë pretendim ankimor Kolegji i Këshillit, se pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar sepse në kohën e nxjerrjes së vendimit për pezullim nga marrëdhënia e punës, kanë qenë në fuqi, Ligji nr. 08/l-294, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 08/l-197 për Zyratet Publik, e jo Ligji Nr.03/l-149, për Shërbimin Civil të Kosovës, andaj mbi bazën e kësaj. Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara.

Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA: A.nr.484/2026

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit N.Sh;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së